



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI KOMUNAL - LIPJAN**  
**DREJTORATI I INSPEKTORATIT**



**DREJTORATI I INSPEKSIONIT**

<b>Datë :</b>	<b>05.03.2026</b>
<b>Referencë</b>	<b>11-344/2</b>
<b>Për :</b>	<b>Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës</b>
<b>Kopje:</b>	<b>Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës</b>
<b>Nga:</b>	<b>Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspeksionit</b>
<b>Lënda :</b>	<b>Raporti i muajit-shkurt</b>

## **PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME**

Gjatë muajit shkurt Drejtoria e Inspektoratit ka ndjekur agjendat e caktuara dhe ka realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës tonë.

Inspektori i mjedisit-ambientit- Janë inspektuar deponit ilegale të mbeturinave në disa fshatra, janë kërkuar edhe dëshmi për ti identifikuar ndotësit.

Janë shqyrtuar ankesat e pranuar nga qytetarët. Problemet më ujëra atmosferik në fshatin Llugaxhi, Janjevë dhe Kraishtë. Ankesat kryesisht kishin të bënin, dëmtim i pronës si pasoj e vërshimeve dhe nevojën e hapjes së kanaleve të ujërave atmosferik. Pas shqyrtimit të ankesave në teren është bërë raport dhe lëndët janë dërguar në kompetencë tek Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim.

Është inspektuar në fshatin Poturovc, një person nga fshati Qylag gjatë shtrirjes së rrjetit elektrik në brezin rrugor Magurë-Lipjan me pëlqim nga MMPHI, gjatë punimeve ka dëmtuar rrethojën e varrezave të vjetra të fshatit. Personit i është dhënë urdhëresë për kohë të caktuar për rregullimin e rrethojës së dëmtuar. Pas ri-inspektimit është parë që është zbatuar urdhëresa.

Sipas ankesave nga një OJQ, është dalë në teren tek Ligatina e Hencit në pjesën e territorit të Komunës sonë, se bashku me Zyrtarin për Ambient në kuadër të drejtorisë së Urbanizmi dhe u pa se është dëmtuar Argjinatura e Ligatinës nga të reshurat e fundit dhe ka rrjedhje të vazhdueshme të ujit nga Ligatina dhe ekziston rreziku që gjatë verës të thahet ligatina. Është bërë raport për gjendjen në teren së bashku dhe ju është dërguar MMPHI e cila është përgjegjëse për kujdesin, sepse këtë zonë e ka shpallur si zonë e mbrojtur me ligj nga kjo ministri.

Gjithë ashtu është realizuar inspektim në deponit ilegale të mbeturinave në fshatrat Gadime e Ulët, Sillovi, Smallushë dhe Akllap, kodrën e Kërçevës, Kraishtë. Nuk është takuar askush dhe nuk u gjete ndonjë dëshmi edhe pse ishin hedhur mbeturina të ndryshme.

Është punuar si pjesë e komisionit për Bujqësi për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në të mbjellurat si pasoj e vërshimeve.

Inspektorët e trafikut- Në bashkëpunim me Inspektorin e Ministrisë së Infrastrukturës për rende të udhëtimit në këtë muaj janë kontrolluar firmat e autobusëve, ku janë bërë disa pika ndalimi dhe janë kontrolluar firma të ndryshme të cilat operojnë në Lipjan.

Janë inspektuar auto-taksit dhe radio taksit në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” janë bërë inspektime vazhdimisht për taksi ilegal dhe për firma të radio taksi që marrin pasagjer pa porosi, për ata që janë takuar duke ushtruar veprimtari ilegale të shërbimit taksi janë marrur masat sipas Ligjit dhe Rregullores komunale duke i shqiptuar gjoba mandatore dhe përjashtim nga komunikacioni për 5 ditë.

Janë bërë edhe inspektime në rrugët e qytetit ku janë të vendosura auto-taksit se a janë të gjithë të pajisur me licenc për ushtrimin e veprimtarisë nga kuvendi komunale për shërbimin taksi.

Gjatë muajit shkurt është bërë inspektimi i tregjeve si: tregut të gjelbër, kafshëve dhe mobileve.

Inspektori i ndërtimit- ka realizuar inspektime të vazhdueshme në teren përgjatë zonave urbanistike. Janë inspektuar objekte të cilat posedojnë leje ndërtimi dhe është konstatuar gjendja e tyre me procesverbal si dhe janë realizu vizita inspektuese me kërkesë të ndërtuesve për fazat ndërtimore. Ndaj ndërtimeve të filluara pa leje ndërtimi është konstatuar gjendja me procesverbal dhe aktvendim për ndalimin e punëve si dhe është bërë vendosja e shiritave zyrtar.

Drejtoria e Inspektoratit është përgjegjur në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët.

## **PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE**

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit shkurt janë:

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.

Inspektim për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve me shumë njësi banimi.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

# STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektime	Inspektime me procesverbal	Objekte të legalizuara	Fletëparaqitje	Njoftime nga DPMUMM-ja	Njoftime	Vërejtje	Pranim teknik me komision (projekte komunale)	Vendosje të shiritave	Inspektime me miratim	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuar	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjyqësore	Konfiskim i targave, librezës dhe kthim	Gjoba mandatore	Njoftim për fillimin e ndërtimeve	Leje ndërtimore	Menaxhim i tregjeve	Aktivendime, ndalesa, urdhëresa	Inspektime për leje Mjedisore Komunale	Inspektim me polici	Inspektime të përbashkëta
Ambienti	24	6			3						13										2	
Ndërtimi	23	4	3						1			12				2	1					
Trafiku	52	5					12			4	12			2	1			9	1		4	2
Gjithsej	99	15	3		3	12			1	4	25	12		2	1	2	1	9	1		6	2

## **DISKUTIMET PUBLIKE**

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

## **TAKIME TË TJERA**

Takimet janë mbajtur me pronar të bizneseve, pronar të ndërtimeve, me taksistë dhe qytetarë të tjerë.

## **SFIDAT**

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese.

Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

## **REKOMANDIMET**

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.